



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

Roli i teknologjisë në zhvillimin e kompetencës sociale dhe në motivimin për të mësuar tek adoleshentët

Autori:

Xheneta Beka Deliu

Mentori:

Prof. Asst. Dr. Blerta Perolli Shehu

Programi:

Master i Shkencave të Edukimit; Këshillim Pedagogjik

Viti akademik:

21.05.2026

Hyrja

Sfidat më komplekse me të cilat po përballlet shoqëria në ditët e sotme shpesh lidhen me ndikimin mbizotërues të rrjeteve sociale në jetën tonë.

Aspekti i përdorimit të teknologjisë, tek adoleshentët e kohës së sotme nuk shihet më si një opsion, por një domosdoshmëri (Ali & Veliz, 2016). Adoleshentët shihen si përdoruesit më të mëdhenj të formave më të reja të komunikimit elektronik (Subrahmanyam & Greenfield, Online Communication and Adolescent Relationships , 2008).

Në Kosovë, zhvillimi i kompetencës sociale tek adoleshentët përmes sistemit shkollor është formalizuar në nivelin kurrikular, por mbetet sfidues në zbatimin praktik.. Mungesa e këshilltarëve pedagogjikë në shkolla dhe mungesa e një qasjeje të koordinuar ndaj mbështetjes socio-emocional përbëjnë faktorë pengues në këtë drejtim, sidomos për faktin që zhvillimi i aftësive sociale interferohet tashmë në masë të madhe edhe nga teknologjia dhe rrjetet sociale. Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë rolin që ka teknologjia në zhvillimin e kompetencës sociale dhe në motivimin për të mësuar tek adoleshentët, konkretisht rolin e rrjeteve sociale në zhvillimin e shkathtësive sociale dhe motivimin e adoleshentëve për rezultate dhe performancë më të mirë në mësim.

1.3.1 Pyetjet hulumtuese

1. Si e perceptojnë adoleshentët rolin e teknologjisë në zhvillimin e shkathtësive sociale?

2. Çfarë ndërlidhje ekziston mes kohës që adoleshentët kalojnë në rrjete sociale dhe shkathtësive të tyre sociale?
3. Çfarë ndërlidhje ekziston mes kohës që adoleshentët kalojnë në rrjete sociale dhe cilësisë së marrëdhënieve të tyre sociale?
4. Cilat janë përvojat e adoleshentëve në tejkalimin e sfidave dhe konflikteve sociale përmes ndërveprimit virtual?
5. Çfarë ndërlidhje ekziston në mes kohës që adoleshentët kalojnë në përdorimin e rrjeteve sociale dhe motivimit për të mësuar?

Hipotezat

Hipoteza 1. Adoleshentët e konsiderojnë të rëndësishëm rolin e teknologjisë në zhvillimin e shkathtësive sociale.

Hipoteza 2. Ekziston ndërlidhje domethënëse pozitive mes shkathtësive sociale të adoleshentëve dhe kohës që ata kalojnë në rrjete sociale.

Hipoteza 3. Ekziston ndërlidhje pozitive mes cilësisë së marrëdhënieve sociale të adoleshentëve dhe kohës që ata kalojnë në rrjete sociale.

Hipoteza 4. Ekziston ndërlidhje signifikante negative mes motivimit për të mësuar dhe kohës që adoleshentët kalojnë në përdorimin e rrjeteve sociale.

Metodologjia

Bazuar në qëllimin e hulumtimit, për të realizuar këtë studim është përdorur metoda mikse e hulumtimit. Përdorimi i metodës mikse sipas Creswell (2009) mundëson mbledhjen e të dhënave nga burime të ndryshme, e kjo bën që problemi i hulumtimit kërkimor të jetë më mirë i shtjelluar.

Për realizimin e këtij hulumtimi, si instrumente kryesore janë përdorur:

Pyetësori është instrument i përgatitur për nevojat e hulumtimit dhe përbëhet nga tri pjesë.

Sa i përket **shkallës për matjen e kompetencës sociale** (Social Competency Rating Form), ajo është marrë e përkthyer dhe pilotuar nga profesoresha e Fakultetit të Edukimit, Dr.sc. Blerta Perolli Shehu.

Grupi i fokusit është një mënyrë për mbledhjen e të dhënave, që mbështetet në dinamikën e grupit për të prodhuar të dhëna cilësore dhe të thelluara (Mathews & Ross, 2010). Në rastin e hulumtimit tonë, kjo mënyrë përshtatet për arsye se mundësohet mbledhja e të dhënave cilësore për idetë dhe të kuptuarit e adoleshentëve mbi teknologjinë dhe rolin e saj.

Rezultatet kryesore

Rezultatet treguan se 76.7% e adoleshentëve përdorin rrjetet sociale për komunikim dhe 55% vlerësojnë se ato ndihmojnë shumë në ruajtjen e marrëdhënieve shoqërore. U gjet një lidhje pozitive dhe statistikisht domethënëse mes kohës në rrjete sociale dhe cilësisë së marrëdhënieve sociale ($r = .323$, $p = .012$), ndërsa lidhja me shkathtësitë sociale ishte e dobët dhe jo domethënëse ($r = .148$, $p = .258$). Gjithashtu, përdorimi i rrjeteve sociale lidhej negativisht me motivimin për të mësuar ($r = -0.348$, $p = .006$). Adoleshentët preferuan komunikimin ballë për ballë për zgjidhjen e konflikteve, megjithëse komunikimi online ndonjëherë ndihmonte ose krijonte keqkuptime.

Diskutimi

Studimi kishte për qëllim të analizojë ndikimin e rrjeteve sociale në kompetencën sociale dhe motivimin për të mësuar tek adoleshentët. Rezultatet treguan se adoleshentët i përdorin rrjetet sociale kryesisht për komunikim dhe ruajtje të marrëdhënieve sociale, ndërsa përdorimi i tyre lidhej pozitivisht me cilësinë e marrëdhënieve, por jo domosdoshmërisht me zhvillimin e shkathtësive sociale. Gjithashtu, u gjet një lidhje negative mes kohës së kaluar në rrjete sociale dhe motivimit për të mësuar, në përputhje me studimet e mëparshme (Hietajärvi, 2019; Kryeziu, 2024). Të dhënat cilësore treguan se adoleshentët preferojnë komunikimin ballë për ballë për zgjidhjen e konflikteve, pasi komunikimi online shpesh sjell keqkuptime. Në tërësi, rezultatet sugjerojnë se ndikimi i teknologjisë varet nga mënyra e përdorimit, mbikëqyrja prindërore dhe faktorë të tjerë socialë (Shehu, 2021).

Përfundimet dhe rekomandimet

Gjetjet e studimit theksojnë rëndësinë e rolit të prindërve dhe mësimeve në promovimin e përdorimit të balancuar të teknologjisë tek adoleshentët. Prindërit duhet të vendosin kufij të arsyeshëm dhe të nxisin vetëdijësimin për ndikimin e rrjeteve sociale, ndërsa mësimeve mund ta përdorin teknologjinë për të rritur bashkëpunimin dhe angazhimin në mësim. Hulumtimet e ardhshme rekomandohet të përfshijnë mostra më të mëdha dhe të analizojnë dallimin mes përdorimit aktiv dhe pasiv të rrjeteve sociale, pasi përdorimi pasiv mund të ndikojë negativisht në mirëqenien emocionale dhe motivimin për të mësuar, ndërsa përdorimi aktiv mund të mbështesë zhvillimin e kompetencës sociale.

Fjalët kyçe: *adoleshencë, kompetencë sociale, teknologji, motivim, mësim.*

Extended Abstract

Title of the Thesis:

The Role of Technology in the Development of Social Competence and Learning Motivation among Adolescents

Author:

Xheneta Beka Deliu

Supervisor:

Prof. Asst. Dr. Blerta Perolli Shehu

Program:

Master of Education Sciences; Pedagogical Counseling

Academic Year:

21.05.2026

Introduction

One of the most complex challenges faced by modern society is related to the dominant influence of social networks on everyday life. For today's adolescents, the use of technology is no longer seen as an option, but as a necessity (Ali & Veliz, 2016). Adolescents are considered the largest users of modern forms of electronic communication (Subrahmanyam & Greenfield, 2008).

In Kosovo, the development of social competence among adolescents has been formally incorporated into the school curriculum; however, its practical implementation remains challenging. The lack of pedagogical counselors in schools and the absence of a coordinated socio-emotional support approach are significant barriers, especially considering that social skills development is increasingly influenced by technology and social media.

The purpose of this study was to explore the role of technology, particularly social networks, in the development of adolescents' social competence and their motivation to learn.

Research Questions

1. How do adolescents perceive the role of technology in the development of social skills?
2. What relationship exists between the time adolescents spend on social networks and their social skills?
3. What relationship exists between the time adolescents spend on social networks and the quality of their social relationships?

4. What are adolescents' experiences in overcoming social challenges and conflicts through virtual interaction?
5. What relationship exists between the time adolescents spend using social networks and their motivation to learn?

Hypotheses

- Adolescents consider technology important for the development of social skills.
- There is a significant positive relationship between adolescents' social skills and the time spent on social networks.
- There is a positive relationship between the quality of adolescents' social relationships and the time spent on social networks.
- There is a significant negative relationship between learning motivation and the time adolescents spend using social networks.

Methodology

This study applied a mixed-methods approach. According to Creswell (2009), mixed methods enable the collection of data from multiple sources, allowing for a more comprehensive understanding of the research problem.

The main research instruments included:

- A questionnaire designed specifically for this study, consisting of three sections.
- The Social Competency Rating Form, translated and piloted by Dr. Blerta Perolli Shehu.
- A focus group interview, which enabled the collection of in-depth qualitative data regarding adolescents' perceptions and experiences with technology (Mathews & Ross, 2010).

Main Findings

The findings showed that 76.7% of adolescents use social networks for communication, while 55% reported that social media greatly help them maintain social relationships. A positive and statistically significant relationship was found between time spent on social networks and the quality of social relationships ($r = .323$, $p = .012$). In contrast, the relationship between social media use and social skills was weak and not statistically significant ($r = .148$, $p = .258$). Furthermore, social media use was negatively associated with learning motivation ($r = -0.348$,

$p = .006$). Adolescents preferred face-to-face communication for resolving conflicts, although online communication was sometimes helpful and at other times led to misunderstandings.

Discussion

The study aimed to analyze the impact of social networks on adolescents' social competence and learning motivation. The results indicated that adolescents primarily use social networks for communication and maintaining relationships. While social media use was positively related to the quality of relationships, it was not necessarily associated with the development of social skills. Additionally, a negative relationship was found between time spent on social media and learning motivation, consistent with previous studies (Hietajärvi, 2019; Kryeziu, 2024).

Qualitative findings revealed that adolescents prefer face-to-face communication when resolving conflicts, as online communication often leads to misunderstandings. Overall, the findings suggest that the impact of technology depends on the way it is used, parental supervision, and other social factors (Shehu, 2021).

Conclusions and Recommendations

The findings highlight the important role of parents and teachers in promoting balanced technology use among adolescents. Parents should establish reasonable limits and encourage awareness of the effects of social media, while teachers can use technology to enhance collaboration and engagement in learning. Future research is recommended to include larger samples and to examine the differences between active and passive social media use, as passive use may negatively affect emotional well-being and learning motivation, whereas active use may support the development of social competence.

Keywords: adolescence, social competence, technology, motivation, learning.